

072
11:20

Nr Prot

Datë 16.11.2023

ANKIM

Ankues: Kualicioni “Bashkë Fitojmë” përfaqësuar me autorizim të posaçëm nga ana e avokatit Arben Llangozi, Franci Nuri dhe Avokati Altin Kazia.

Objekti: Ankim kundër vendimit të “KQZ” rrëzimin e kërkesës së Kualicioni “Bashkë Fitojmë” për të shpallur të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë, z. Kreshnik Hajdari. Ky vendim i njoftohet menjëherë Kryeministrit për të vijuar me procedurat e parashikuara nga neni 115 i Kushtetutës. Në lidhje me shqyrtimin e projektvendit “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues z. Kreshnik Riza Hajdari, Kryetar i Bashkisë Kuçovë, Qarku Berat, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” datë 14 nëntor 2023, ora 12:00, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Baza ligjore: Kodi Zgjedhor, ligji nr 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” vendimit të Kuvendit Nr. 17/2016 Neni 10,128,137 Kodi i Procedurave Administrative.

Drejtuar: Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, pranë Komisionit Qendror Zgjedhor.

Të nderuar

Të nderuar “KQZ”-ja ka marrë një vendim absurd dhe haptaz në kundërshtim me ligjinku ka vendosur, rrëzimin e kërkesës së Kualicioni “Bashkë Fitojmë” për të shpallur të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë, z. Kreshnik Hajdari. Ky vendim i njoftohet menjëherë Kryeministrit për të vijuar me procedurat e parashikuara nga neni 115 i Kushtetutës. Në lidhje me shqyrtimin e projektvendit “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues z. Kreshnik Riza Hajdari, Kryetar i Bashkisë Kuçovë, Qarku Berat, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” datë 14 nëntor 2023, ora 12:00, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Në lidhje me çështjen me objek ku është duke u Projektvendim “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues z. Kreshnik Riza Hajdari, Kryetar i Bashkisë Kuçovë, Qarku Berat, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”. Ditën e martë, datë 14 nëntor 2023, ora 12:00, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve zhvillon seancën publike me këtë rend dite:


Shtetasi Kreshnik Hajdari, ka kandiduar për të njëjtën detyrësi përfaqësues i subjektit zgjedhor “Partian Socialiste e Shqipërisë”. Ky shtetas në funksion të kandidimit ka plotësuar dhe dorëzuar në KQZ, formularin e dekriminalizimit, sipas Kodit Zgjedhor dhe ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Në këtë formular, pyetjes - a keni qënë i dënuar jashtështë shtetit, ai i është përgjigjur, JO. Kjo është rrethanë e pavërtetë pasi unë përmes përfaqësuesve të mi, kemi paraqitur si provë në KQZ, një vendim gjyqësor penal të formës së prerë, të Gjykatës greke, me të cilin rezulton se ai është dënuar me 4 muaj burgim (të kovertuar me gjobë në masën 1500 dhrahmi) për veprën penale të kalimit

9. 13

të paligjshëm të kufirit. Ky dënim penal, jo vetëm nuk është deklaruar por është bërë deklarim i rremë. Ky mosdeklarim bie në fushën e zbatimit të pikave 1 (shkronja “ç”) dhe 3 (shkronjat “b” dhe “ç”) të kreut 3 të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016. Për rrjedhojë, shtetasi Kreshnik Hajdari, është në kushtet e pazgjedhshmërisë në funksionin e kryetarit të Bashkisë Kuçovë, sipas shkronjës “ç”, të pikës 3 të kreut 3 të vendimit 17/2016 të Kuvendit. Këtu duhet bërë një dallim thelbësor. Shtetasi Kreshnik Hajdari, në zbatim të dispozitave të mësipërme, është në kushtet e pazgjedhshmërisë, jo se përfshihet në kushtet e ndalimit të parashikuara në nenet 2 dhe 3 të ligjit 138/2016, (situatë kjo që do të ishte ngjashme me rastin e trajtuar nga praktika e Kolegjit Zgjedhor për kryetarin e Bashkisë Mallakastër). Në dallim nga rasti i K.bashkisë Mallakastër, shtetasi Kreshnik Hajdari përfshihet në kushtet e pazgjedhshmërisë se ka gënjer në formularin e dekriminalizimit, gjë që sipas shkronjës “ç” të pikës 3 të kreut 3 të vendimit 17./2016 të Kuvendit, passjell menjëherë dhe në çdo kohë, pavlefshmërinë e kandidimit dhe të zgjedhjeve edhe në hipotëzën se ai i fiton zgjedhjet.

KQZ (e përbërë nga KSHZ KAS), me vetëdije ka bërë se nuk e ka kuptuar kërkimin tonë për pavlefshmëri. Konkretisht, KQZ ka konfunduar kushtet e ndalimit të zgjedhshmërisë, sipas neneve 2 dhe 3 të ligjit 138/2015, (rasti i parë), me kushtet e ndalimit të kandidimit/zgjedhshmërisë dhe/apo mundësisë së marrjes së mandatit sipas shkronjës “ç” të pikës 3 të kreut 3 të vendimit të kuvendit 17/2016, (që është rasti i dytë dhe që konkretisht është rasti jonë). Në rastin e parë verifikimi i kushteve të ndalimit bëhet përmes verifikimit të thelluar nga ana e prokurorisë së përgjithshme, ndërsa në rastin e dytë, (që është rasti jonë), bëhet nga vetë organi që administron formularin e dekriminalizimit dhe verifikimi nga ana e prokurorisë së përgjithshme, nuk është kusht. Kjo pasi në rastin e dytë, bëhet fjalë për rastin e deklarimit të rremë apo të pasaktë në formularin e dekriminalizimit dhe vet ligji nëpërmjet shkronjës “ç” të pikës 3 të kreut 3 të vendimit të kuvendit 17/2016 parashikon mënyrën e zgjidhjes së pasojës që është pavlefshmeria e zgjedhjeve edhe në rastin aktual që Kreshnik Hajdari rezulton fitues. Kjo mënyrë e interpretimeve të normës trajtohet edhe në nenin 10 të ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” që parashikmon shprehimisht mënyrën e zgjidhjes së pavlefshmërisë në rastin tonë. Nga ana tjetër edhe vet kodi zgjedhor nëpërmjet nenit 123 paragrafi 6 parashikon këtë fakt “

Në zbatim të kësaj norme, KQZ, edhe nëse “me të drejtë” nuk do të arrinte të kuptonte natyrën juridike të kërkesës tonë për pavlefshmëri, do duhej që kryesisht, të zgjidhte pavlefshmërinë, për sa kohë në kemi paraqitur prova të qarta se shtetasi Kreshnik Hajdari ka gënjer në formularin e dekriminalizimit fakt ky që I jep vlerën zero këtij formulari. Pra, në përmbledhje, rezulton se nga interpretimi krahasimor, sintetik, logjik dhe literal, i nenit 10 të ligjit 138/2015, i nenit 123 paragrafi 6 të Kodit Zgjedhor, I pikës 3 (shkronjat “ç”) të kreut 3 të vendimit të Kuvendit 17/2016 dhe nenit 92 shkronjat “a” dhe “b” të Kodit Civil, deklarimi i rreme i konsumuar nga shtetasi Kreshnik Hajdari në Formularin e Dekriminalizimit, shkakton pavlefshmërinë absolute të këtij veprimi juridik dhe në analizë të fundit, pamundësi të fitimit të tij të mandatit, edhe nëse ai rezulton se ka marrë një numër votash të vlefshme, më të madh nga unë Lefter Maliqi. **Ky verifikim i kushtit ndalues, bëhet menjëherë dhe në çdo kohë.** Detyrimi për veprim të menjëhershëm, i parashikuar në shkronjën “ç” të pikës 3 të kreut 3 të vendimit 17/2016 të Kuvendit, e nënkupton kompetencën ligjore të çdo organi të KQZ (pra sit ë KSHZ ashtu edhe KAS), madje edhe të Kolegjit Zgjedhor



gjqësor, për t'a konstatuar këtë kusht ndalues të fitimit të mandatit kur ka prova të qarta të deklarimit të rremë (sikurse ka ndodhur në rastin tonë lidhur me shtetasin Kreshnik Hajdari).

Për më tepër shtetasi Kreshnik Hajdari do duhej që vendimin e dënimit penal të lartëpërmëndur, do duhej që t'a deklaronte në formularin e dekriminalizimit. Kjo sipas nenit 5 paragrafët 1 dhe 2. Këto dispozita parashikojnë si më poshtë

1. *Personat e parashikuar nga nenet 2 dhe 3, të këtij ligji, duhet të plotësojnë e të nënshkruajnë një formular vetëdeklarimi, me anë të të cilit deklarojnë mosekzistencën e shkaqeve për të kandiduar, për të mos u zgjedhur ose emëruar.*

2. *Refuzimi për të dorëzuar formularin e vetëdeklarimit ose mosparaqitja e formularit të vetëdeklarimit përbën shkak për mosregjistrimin e kandidatit në zgjedhje nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve apo për mosemërimin nga organi përgjegjës sipas ligjit. Modeli i formularit të vetëdeklarimit miratohet me vendim të Kuvendit.*

Duke mos deklaruar dënimin penal si më sipër shtetasi Kreshnik Hajdari, ka konsumuar vepren penale të Fallsifikimit të formularëve të parashikuar nga neni 190/2 i Kodit Penal.

Faktin e mësipërm, ua kemi bërë me dije duke depozituar si provë vendimin penal të gjykatës greke, të përkthyer, të noterizuar si dhe me vulë apostile, që përpara shtypjes së fletëve të votimit, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve si dhe Kas-It (përmes kërkesës ankimore) duke iu kërkuar këtyre institucioneve, marrjen e masave të parashikuara në nenin 10 të Ligjit 138/2015, që parashikon si më poshtë, por së fundmi të njëjtin fakt e ka konstatuar edhe Prokuroria e Përgjithshme.

Neni 10: Veprimet e organeve kompetente kur verifikohen kushtet e ndalimit.

1. *Kur verifikohen kushtet për moskandidim dhe moszgjedhje, në përputhje me këtë ligj, **KOZ-ja¹ kryen veprimet e mëposhtme:***

a) *refuzon kandidaturën e personit, kur kushtet verifikohen para procesit të pranimit të kandidaturave, dhe i kërkon subjektit zgjedhor të interesuar të zëvendësojë kandidaturën brenda afatit të parashikuar për dorëzimin e kandidaturave;*

b) *heq kandidatin nga kandidimi kur kushtet verifikohen para shtypjes së fletëve të votimit pa të drejtë zëvendësimi për rastin e kandidatëve për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore apo për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për këshillin e njësisë së qeverisjes vendore;*

c) *kur kushtet e moskandidimit verifikohen pas shtypjes së fletëve të votimit dhe para shpalljes së rezultateve:*

i) *shpall pavlefshmërinë e zgjedhjeve në zonën zgjedhore përkatëse kur verifikohen kushtet për moskandidim dhe moszgjedhje të personit që ka të drejtën e mandatit të kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, mbi bazën e votave të marra;*

ii) *shpall rezultatin për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore kur verifikohen kushtet për moskandidim dhe moszgjedhje, sipas këtij neni, për një kandidat që nuk është fitues, dhe shpall faktin e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë për kandidatin përkatës;*

¹ Pra Komisioneri qendror i zgjedhjeve dhe/ose Kas-i apo Kolegji Zgjedhor në Gjykatën Administrative të Apelit.

iii) përjashton nga përlogaritja e mandateve kandidatin e propozuar nga zgjedhësit për këshilltar në këshillin e njësisë së qeverisjes vendore përkatëse dhe përlogarit mandatet, duke përjashtuar votat e marra prej tij;

iv) shpall fitues nga lista shumemërore kandidatin vijues në renditje dhe në përputhje me kuotën gjinore, si dhe shpall faktin e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë për kandidatin përkatës;

ç) shpall pavlefshmërinë e mandatit kur kushtet e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë verifikohen pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve, në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe para fillimit të ushtrimit të mandatit nga personi i shpallur i zgjedhur në kundërshtim me këtë nen, si dhe shpall mandatin, në përputhje me Kodin Zgjedhor;

d) shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit kur kushtet e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë verifikohen pas fillimit të ushtrimit të mandatit nga personi përkatës, si dhe shpall mandatin në përputhje me këtë Kod, si dhe njofton Kryetarin e Kuvendit, në rastin e pavlefshmërisë së mandatit të deputetit, apo Kryeministrin, në rastin e kryetarit të bashkisë apo të këshilltarit bashkiak.

2. Kur deputeti mban në të njëjtën kohë postin e anëtarit të Këshillit të Ministrave, Kryeministri i propozon Presidentit, brenda 48 orëve, shkarkimin e ministrit.


3. Në rast se kushtet e pavlefshmërisë së mandatit verifikohen për Kryeministrin, ai i paraqet Kuvendit mocion besimi, brenda 48 orëve, në përputhje me nenin 104 të Kushtetutës, dhe Kuvendi miraton shkarkimin e tij nga detyra.

4. Në rast se anëtari i Këshillit të Ministrave nuk ka mandat deputeti, konstatimi i kushteve për moszgjedhshmëri dhe ushtrim të funksionit publik, sipas nenit 2, të këtij ligji, zbatohen, sipas rastit, pika 2 ose 3 e këtij neni.

5. Për personat që plotësojnë kushtet shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi që zbatohet për ta është vetëm pezullimi i ushtrimit të funksionit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 1, të nenit 16, të këtij ligji. Pezullimi zgjat përgjatë gjithë periudhës që ekzistojnë rrethanat për të cilat zbatohet ky ndalim. Pezullimi mbaron kur personi shpallet i pafajshëm. Kur personi dënohet me vendim përfundimtar të formës së prerë, ndaj tij zbatohen dispozitat përkatëse të këtij ligji, sipas llojit të veprës apo dënimit.

6. Në rastet kur organet e ngarkuara nga Kushtetuta apo ligji për konstatimin e mbarimit apo pavlefshmërisë së mandatit, ose shkarkimin nga detyra të funksionarit të lartë publik, nuk veprojnë brenda 10 ditëve nga përfundimi i rezultateve të verifikimit, me kërkesë të 1/5 së deputetëve të Kuvendit, çështja i përcillet për shqyrtim Gjykatës Kushtetuese, e cila vendos konstatimin e mbarimit apo pavlefshmërisë së mandatit, ose shkarkimin nga detyra të funksionarit të lartë publik, kur plotësohen kushtet dhe rrethanat, sipas këtij ligji.

5. Jo vetëm që as K.SH.Z por edhe "KAS" nuk ka marrë asnjë masë për të bërë të zbatueshëm nenin 10 të ligjit 138/2023 por madje Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së ka guxuar të zhdukë provën origjinale që ne kemi dorëzuar në KQZ, që përpara shtypjes së fletëve të votimit, (pra vendimin e gjykatës greke), duke mos ia përcjellë atë për verifikim Prokurorisë së Përgjithshme. (shih përgjigjen që sekretari i Përgjithshëm i KQZ i ka kthyer përfaqësuesve të mi, në rrugë elektronike, me emailin e dates 06.06.2023, ora 20:08). Ky fakt u vërtetua edhe përmes pohimeve të dhëna nga sekretari i Përgjithshëm i KQZ, në seancën dëgjimore të zhvilluar në KAS, në datën 12.06.2023, (dëgjo rregjistrimet audio).



Për pavlefshmërinë e formularit të dekriminalizimit u shprehëm më sipër. Kolegji zgjedhor dhe/apo KQZ (KSHZ dhe KAS) ka detyrim t'a shqyrtojë në meritë këtë pretendim. Kjo jo vetëm për shkak se një gjë e tillë **parashikohet si detyrim edhe kryesisht**, (pra, jo e drejtë por detyrim) në nenin 10 të ligjit 138/2015, nenin 123 paragrafi 6 të Kodit Zgjedhor, pikën 3 (shkronjat "ç") të kreut 3 të vendimit të Kuvendit 17/2016 si dhe në nenin 92 shkronjat "a" dhe "b" të Kodit Civil².


Veç sa më sipër edhe praktika e unifikuar me vendimin nr. 1/2009 e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, iu ngarkon Gjykatave detyrimin (jo të drejtën) që kur konstatojnë/individualizojnë veprimeve juridike absolutisht të pavlefshme gjatë shqyrtimit të mosmarrëveshjeve, t'ë analizojnë edhe kryesisht ndikimin e këtyre paligjshmërive në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Nëse palët kanë kërkuar zgjidhjen e pasojave, (sikurse është rasti jonë), Gjykatat janë të detyruara (pra nuk e kanë të drejtë por e kanë detyrim), që të shprehen.

Edhe kolegji penal i gjykatës së lartë në vendimin me **Nr. 53805-00551-00-2018 i Regj. Themeltar Nr. 00-2023-1569 i Vendimit (215) datë 24.07.2023, ka konstatuar se, referuar përmbajtjes së formularit të vetëdeklarimit, i dalë në zbatim të ligjit nr. 138/2015, i miratuar me vendimin nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, subjektet deklarues që përcaktohen në këtë ligj kanë detyrim të pasqyrojnë në formular çdo dënim penal të formës së prerë të dhënë nga një autoritet gjyqësor shqiptar apo i huaj, pavarësisht llojit të veprës penale dhe llojit e masës së dënimit të dhënë. Madje në rubrikën "Marrje dijëni mbi efektet e formularit të vetëdeklarimit" (në pikën "b" të saj), parashikohet se: "*Pasqyrimi i të dhënave të rreme në këtë formular përbën veprë penale dhe dënohet sipas nenit 190 të Kodit Penal.*"**

Sipas në vendimin me **Nr. 53805-00551-00-2018 i Regj. Themeltar Nr. 00-2023-1569 i Vendimit (215)**, 24.07.2023, qëllimi i ligjvënësit, në miratimin e ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", lidhet me detyrimin ligjor të subjekteve të këtij ligji, për të deklaruar të dhënat e kërkuara, duke përcaktuar edhe se ku konsiston ky deklarim dhe duke e strukturuar atë në disa kërkesa specifike dhe për një kategori të përcaktuar veprash penale. Në këtë kuptim, të gjitha rregullimet, normimet e bëra në funksion të zbatimit të këtij ligji, të cilat mundësojnë zbatimin e tij, duhen konsideruar dhe interpretuar brenda qëllimit të vetë ligjit, pasi çdo interpretim ndryshe do të sillte denatyrimin të këtij qëllimi/vullneti të legjislatorit.

Sipas në vendimin me **Nr. 53805-00551-00-2018 i Regj. Themeltar Nr. 00-2023-1569 i Vendimit (215)**, Sipas në vendimin me **Nr. 53805-00551-00-2018 i Regj. Themeltar Nr. 00-2023-1569 i Vendimit (215)**, 24.07.2023, konstatohet se detyrimi i caktuar ndaj subjekteve të ligjit, në formularin e vetëdeklarimit, është brenda frymës të vetë ligjit. Qënia i dënuar i subjektit të këtij ligji me vendim përfundimtar ose ndaj të cilit janë marrë masa sigurimi apo është dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen të krimeve të parashikuara nga vetë ligji nr. 138/2015, përbën shkak ndalues për zgjedhjen ose emërimin e tij në organet të zgjedhura shtetërore, institucionet e pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të administratës publike etj, apo shkak për largimin e tij nga këto funksione publike. Ndërsa, mosdeklarimi fshehja, deklarimi i pasaktë ose i

² Paraqitja e këtij formulari dekriminalizimi, është veprim juridik civil i njëanshëm. Kjo pasi përmes tij shtetasi Kreshnik, në mënyrë të lirë dhe të vullnetshme, e ka kryer këtë veprim me qëllim për të krijuar një marrëdhënie juridike, që sjell ndër të tjera edhe lindjen në favor të tij, të të drejtave dhe detyrimeve në natyrë juridiko-civile.




remë nga subjekti deklarues, në formularin e vetëdeklarimit, të çdo dënimi të formës së prerë (të dhënë nga autoritet gjyqësore shqiptare apo të huaj), përbën paraqitje të rrethanave të rreme para organeve shtetërore, në kuptim të ligjit penal (nenit 190 i Kodit Penal).

Në rastin konkretë, provohet se i kallzuari Kreshnik Hajdari, nuk ka deklaruar faktin se ndaj tij është marrë një masë deportimi, dhe masën e dënimit pra duke vendosur shenjën "X" në përgjigjen negative, në rubrikën e formularit të vetëdeklarimit të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 138/2015, datë 17.12.2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen emërohen ose ushtrojnë funksione publike", dhe pikërisht në përgjigje të pyetjes "A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj?", Hajdari i është përgjigjur në kuadratin "JO". Por edhe për faktin e dënimit ka deklaruar JO, Fakt ky i pavërtetë dhe e bën formularin e pastërtisë së Figurës të falsifikuar. Pasi referuar Kthim përgjigjes së Departamentit të Policisë Kriminale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me shkresën nr. 2931/6 prot., datë 19.07.2023 informon për shtetasin Kreshnik Hajdari se ka marrë informacion nga Interpol Athina Greqi ku thuhet se :**shtetasi i mësipërm është regjistruar më datë 27.03.2017 nga Security-Sub-Division of Jannina pasi është deportuar në Shqipëri.** Por njëkohësisht po nga shteti Grek është konfirmuar se shtetasi Kreshnik Hajdari rezultoi i dënuar në shtetin Grek dhe Hajdari ka deklaruar se është i padënuar.


Kreshnik Hajdari si subjekt i ligjit nr. 138/2015, ka përpiluar një dokument/formular vetëdeklarimi, paraqitja e të cilit pranë institucioneve të parashikuara në ligj, i jep udhë fillimit të një procedure të mëtejshme verifikimi dhe vlerësimi. Ai ka pasur detyrimin për të deklaruar me vërtetësi çdo të dhënë të kërkuar në formularin e vetëdeklarimit, por në fakt ka paraqitur të dhëna të pavërteta, duke konsumuar kështu elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 190/2 i Kodit Penal.

Kreshnik Hajdari megjithëse e ka ditur detyrimin ligjor dhe qëllim e ligjit e shprehur që në nenin 1 të tij, ka plotësuar formularin me të dhëna që nuk janë të vërteta. Pavarësisht "justifikimit" se "e ka kuptuar pyetjen gabim", se "është shtënë në lajthim" apo se ka "besuar se dënimi dhe deportimi nuk ishte detyrim për t'u deklaruar" rezultoi se pyetja është e qartë dhe e kuptueshme, e shprehur në termin "A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit apo dënimit nga një shtet i huaj?". Pra, pavarësisht kohës i Hajdari, si subjekt që përmban detyrimin për deklarim ka patur detyrimin për plotësimin e çdo rubrike me saktësi dhe duke pasqyruar informacion real. Gjithashtu Hajdari nëpërmjet deklaratës së nënshkruar në faqen 2 të formularit është paralajmëruar se pasqyrimi i të dhënave të pavërteta përbën veprë penale dhe dënohet sipas nenit 190/1 i K.Penal ...".

Edhe në vendimin për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të prokurorisë së përgjithshme për funksionarin publik z. agim ymer kajmaku, me funksion kryetar i bashkisë vorë, qarku tiranë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 01.11.2019 në lidhje me çështjen për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Agim Ymer Kajmaku, me funksion Kryetar i Bashkisë Vorë, Qarku Tiranë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të rezultateve të verifikimit nga Prokuroria e Përgjithshme, vlerëson se për sa i përket procedurave të ndjekura, për rezultatet e verifikimit në lidhje me të dhënat në formularin e deklaramit, referuar pikës 1 dhe 2 të nenit 8 të ligjit 138/2015 dhe pikës 5 të Kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, është kompetencë e Prokurorisë së Përgjithshme. Në Kreun III, pika 3, ç) të Vendimit nr.17/2016 të Kuvendit parashikohet se: **“...pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota dhe të pasakta në të, pasjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik”**. Gjithashtu, subjektet mbajnë përgjegjësinë e plotë dhe janë të vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota dhe të pasakta, në lidhje me të kaluarën e tyre. Duke nënshkruar në pikën II të formularit, “Marrja dijeni mbi efektet e formularit të vetëdeklarimit”, shkronja d) “Pasyqrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në këtë Formular dhe refuzimi i depozitimit të gjurmëve daktiloskopike, pasjell skualifikimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo ushtrimi i menjëhershëm i funksionit publik”. Nga dokumentacioni i përcjellë, konkludohet se, subjekti nuk ka deklaruar informacionet që lidhen me hetimet në ngarkim të tij, pavarësisht detyrimit ligjor që buron nga pyetja 3 e formularit të vetëdeklarimit i cili parashikon : “A keni qenë ndonjëherë në hetim apo gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre penale?”. Duke mos i pasqyruar faktet e mësipërme në formular, konkludohet se veprimi i tij bie në fushën e zbatimit të pikës 3/ç, të KREUT III, të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme vlerëson se: Prokuroria e Përgjithshme, ka kryer verifikimin e të dhënave dhe referuar informacionit të ardhur nga Interpol/Athina/Greqi, ka konstatuar se funksionari z. Agim Ymer Kajmaku (alias Jorgo Toto) është arrestuar me datë 14.01.2003 në Greqi për qarkullim monedhash të falsifikuara. Deri më datë 13.09.2019, datë kur është marrë vendimi 236/2019 i Gjykatës së Janinës, ku është shpallur i pafajshëm, rezulton se ndaj tij ka pasur urdhër arresti kombëtar (grek) dhe evropian, për këtë shtetas. Duke qenë se funksionari publik është përgjigjur me “jo” pyetjeve të formularit të vetëdeklarimit “A keni qenë ndonjëherë në hetim apo ne gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre penale?” dhe “A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese për kryerjen e një vepre penale”, rezulton se ai nuk ka deklaruar se ndaj tij ka patur hetim, ndalim, apo gjykim nga autoritetet ligj zbatuese Greke. Gjithashtu funksionari i është përgjigjur me “Jo” pyetjeve të formularit të vetdeklarimit “A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në Nr. 1101 i vendimit Data 01.11.2019 e vendimit Ora 10:00 e vendimit “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Agim Ymer Kajmaku, me funksion Kryetar i Bashkisë Vorë, Qarku Tiranë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. fuqi ose jo?”, dhe “A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj”, rezulton se ai nuk ka deklaruar se ndaj tij ka patur masë shtrënguese e sigurisë personale apo masë dëbimi. Personi i cili sipas autoriteteve greke është arrestuar dhe gjykuar për veprën penale të qarkullimit të monedhave të falsifikuara ka përdorur të dhëna identiteti Jorgo Toto, të cilat nga analiza e gjurmëve të gishtave përputhen me të dhënat aktuale të z. Agim Ymer Kajmaku. Neni 2, pika 3, i ligjit 138/2015, parashikon se “Ndalimet e parashikuara në këtë nen zbatohen edhe ndaj personave që, në kohën e kryerjes apo tentativës së kryerjes të veprës penale, të parashikuar në këtë ligj, mbanin të dhëna identiteti të ndryshme nga ato që mbajnë në momentin kur zbatohet ndalimi ndaj tyre. Subjekti Z. Agim Ymer Kajmaku rezulton se ka përdorur në shtetin grek gjenealitete të tjera, të deklaruara si Jorgo Toto në Formularin e Vetëdeklarimit, por nuk ka deklaruar arrestimin e tij



dhe faktin që në momentin e kandidimit ndaj tij ka qënë në fuqi një urdhër arresti kombëtar në shtetin grek dhe urdhër arresti evropian. Kreu III, pika 3, gërma “ç” parashikon “Formulari i Vetëdeklarimit përmban detyrimisht një rubrikë ku pasqyrohet se... Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta të paplota dhe të pasakta në të pasjell përjashtimin e mënjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik. Në lidhje me faktin nëse mosdeklarimi i të dhënave të cilat parashikohen në pyetjet e formularit të vetëdeklarimit, përbëjnë shkak për ndalimin e ushtrimit të funksionit Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, është shprehur gjerësisht rast pas rasti dhe në vendimet e mëparëshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr.138/20151 . Gjithashtu vendimet e KQZ për raste të ngjashme janë ankuar në rrugë gjyqësore dhe Gjykata Administrative i ka lënë në fuqi.2 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referuar praktikave të deritanishme ka vlerësuar individualisht për çdo funksionar publikë të trajtuar sipas ligjit 138/2015, të dhënat e padeklaruar, arsyen nëse fshehja e tyre nga deklarimi është e qëllimshme apo jo. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referuar gjetjeve të Prokurorisë së Përgjithshme në vendimin e rezultatit të Verifikimit në zbatim të ligjit 138/2015 për z. Agim Ymer Kajmaku me funksion kryetar i Bashkisë Vorë, konstaton se: Më datë 13.09.2019, sipas vendimit Nr.236/2019 të Gjykatës së Janinës, subjekti Agim Ymer Kajmaku alias Jorgo Toto, është shpallur i pafajshëm për veprën penale të qarkullimit të monedhave të falsifikuara. Sa më sipër bazuar në këtë vendim pas kësaj date autoritetet gjyqësore Greke kanë revokuar urdhër arrestin kombëtar dhe evropian, për këtë shtetas. Subjekti z. Agim Kajmaku në datën e fillimit të detyrës, (5 gusht 2019) nuk ka deklaruar faktin e procedimit penal të regjistruar ndaj tij nga autoritetet greke të drejtësisë për veprën penale të qarkullimit të monedhave të falsifikuara; faktin që ka qënë në gjykim nga autoritetet Greke të drejtësisë, apo që ai ka qënë arrestuar dhe se ndaj tij ka pasur urdhër arresti në fuqi në shtetin Grek, dhe urdhër arresti evropian në fuqi, me gjenealitetet Jorgo Toto. Në lidhje me fuqinë prapavepruese të Ligjit nr. 138/2015, i referohemi jurisprudencës gjyqësore. Kështu, në Vendimin 80-2017-422, datë 10.02.2017, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë 1 Vendimet e KQZ-së për çështjen G. Rahovica dhe A. Rakipi, respektivisht nr. 3 dhe 4 , datë 5.01.2018 2 Vendimet e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë nr. 80-2018-4702, datë 24.12.2018 dhe nr. 416(80-2019-432), datë 12.02.2019 Nr. 1101 i vendimit Data 01.11.2019 e vendimit Ora 10:00 e vendimit “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Agim Ymer Kajmaku, me funksion Kryetar i Bashkisë Vorë, Qarku Tiranë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. (vendimi ka marrë formë të prerë, pasi nuk është ankimuar) shprehet (në atë rast, në lidhje me ishdeputetin, z.Dashamir Tahiri) se, “pavarësisht se paditësi më datë 29.12.2016 duhej konsideruar si i rehabilituar, mandati i tij si deputet i fituar përmes bërjes së betimit në fillim të shtatorit 2013, është mandat i fituar në kushtet e ndalimit sipas ligjit nr. 138/2015. Konkretisht, bazuar në nenin 14, paragrafi 3 të tij, llogaritja e periudhës së ndalimit fillon nga data e fillimit të detyrës apo e mandatit në vazhdim dhe shtrihet në periudhën që i paraprin kësaj periudhe.” Në këto kushte funksionari publik ka paraqitur rrethana apo të dhëna të rreme në formularët e vetëdeklarimit, depozituar ne Komisionin Qendror të zgjedhjeve në datë 13.05.2019. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar gjetjeve të Prokurorisë së Përgjithshme vlerëson se mosdeklarimi në formularin e vetëdeklarimit dorëzuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me datë 13.05.2019, të arrestimit, hetimeve dhe vendosjes ndaj tij të urdhër arrestit dhe fshehja e tyre, ka qënë me qëllim, për të penguar institucionet e ngarkuara nga ligji nr. 138/2015 për të kryer verifikim të plotë dhe të gjithanshëm, duke qënë se në momentin e plotësimit dhe të dorëzimit të formularit të vetdeklarimit në KQZ ende nuk kishte përfunduar gjykimi i çështjes penale në ngarkim të këtij subjekti dhe respektivisht nuk dihej sesi do të ishte vendimarrja e gjykatës



përkatëse. Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve për vitin 2016”. Shprehet se : “.....Qëllimi i ligjit nr.138/2015, është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore ,të institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, si dhe të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to,apo largimit nga funksioni publik i atyre personave, për të cilët ekzistojnë shkaqet ligjore për të mos u kandiduar, për t’u zgjedhur, apo emeruar, por jo të personave që, për një arsye që nuk lidhet me fshehjen e qëllimshme, kanë referuar të dhëna të ndryshme apo të paplota në raport me të dhënat e gjendura ne regjistrat.3) Sipas interpretimit të Kuvendit vetëm nëse fshehja e të dhënave është e paqëllimshme funksionari nuk është në kushtet për ndalimin e zgjedhjes ose emërimit, apo largimit nga funksioni publik. Në kuadër të zbatimit të Vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Shqipërisë, informacion i ardhur nga institucioni i Prokurorisë krijon bindjen se funksionari ka shkelur dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me zbatimin e drejtë, transparencën dhe frymën me të cilën funksionon ligji nr. 138/2015 “Për verifikimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike”, dhe rregullimet e detajuara të parashikuara në vendimin nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, vlerëson se funksionari publik, Kryetar i Bashkisë Vorë, z. Agim Ymer Kajmaku, referuar gërmës “ç”, pikës 3, Kreut III të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, është në kushtet për ndalimin e ushtrimit të funksionit.

Për sa më sipër

KËRKOJMË

“Të shpallë të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë , z. Kreshnik Hajdari. Ky vendim i njoftohet menjëherë Kryeministrit për të vijuar me procedurat e parashikuara nga neni 115 i Kushtetutës.”.

KUALICIONI BASHKË FITOJMË


PËRFAQSUAR NGA

AVOKAT

ARBEN LLANGOZI



FRANCI NURI



ALTIN KAZIA

